



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2019:143707

Datë: 04.09.2019

Numri i dokumentit: 00493045

P.nr.306/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL Sipas gjyqtarit Nexhat Aliu, me Sek. Juridike, Azize Rama, në qështjen penale të pandehures P.H. nga fshati ..., K.Viti, të cilen me autorizim e mbron av. A.H. nga Vitia, për shkak të veprës penale, organizim i skemave piramidale dhe bixhozit te pa ligjshem nga neni 294 parag.2 të KPRK-së, e sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjilan, departamenti i përgjithshem, PP-II-nr. 999/2019 të dates 24 korrik 2019, të cilen e perfaqsonte prokurorja e shtetit Rozolida Manastiri pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqsorë, lidhur me marveshjen për pranimin e fajsisë dhe sanksionin penal të dt.26.07.2019, me dt. 31.07.2019, morri dhe në prezencën e palve shpalli këte:

A K T G J Y K I M

E pandehura P.H. nga babai ... , nëna ... , e lindur ... , e lindur me ... në Gjilan tani me venbanim në fsh.... K.Viti, me numer personal ... , ka të kryer fakultetin ekonomik , e pa punë, me gjendje te mesme ekonomike , e pa martuar, gjer më tani e pa denuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R Ë S E P S E

Me datën 02.korrik 2019, rreth ores 19:00 minuta, në rrugen “...” në fsh..., K.Viti, pas nje kontrolle nga ana e zyrtareve policor nga policia e Kosoves-NJHRKEK, në Gjilan, është konstatuar që e pandehura P.H me qellim te perfitimit te kunderligjem pasuror per vete apo per personin tjetër dhe ne kundershtim me ligin per ndalimin e lojërave te fatit 06/1-155 në mënyre të kunderligjshem ka organizuar lojërat e fatit “.....”” dhe

-me çka ka kryer vepër penale organizim i skenave piramidale dhe bixhozit te pa ligjshem nga neni 294 parag.2, të KPRK-së,

-andaj gjykata duke ju referuar marrveshjes së arritur me shkrim mesë prokurorisë Themelore në Gjilan dhe të akuzuarës dhe mbrojtësit të saj si dhe dispozitave ligjore nenit 41, 46, 73 dhe 75 të KPRK-së dhe nenit 365, të KPPRK-së.

E G J Y K O N

I.Me denim burgu efektiv në kohzgjatje prej 60 (Gjashtdhjet) ditësh.

II.E në bazë të nenit 47 paragrafi 1, të KPRK-së, dhe me pelqimin e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij ja shëndrron në **dënim gjobe në shumë prej 1.200 Euro** (Njëmijë e dyqin euro), të cilin dënim ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh, pasë plotëfuqishmerise së këtij aktgjykimi.

III. Në bazë të nenit 83 paragrafi 1 të KPRK-së, duke ja llogaritur edhe kohen e kaluar nën masen e arrestit shtepiak prej dt.03.07.2019, deri me dt.31.07.2019, e akuzuara 30 ditë ka qendruar nën masen e arrestit shtepijak, që do të thot se e akuzuara ka per ta paguar shumen prej 600 Euro. (gjashqin euro), pasë plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi.

OBLIGOHET e akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës të paguaj shumën prej **20,00 € (njizete euro)**, ndërsa në emër të paushallit gjyqsor shumën prej nga **10,00 € (dhjet euro)**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet të paguaj taksen në shum prej 30 Euro, për kompensimin e viktimave të krimit në bazë të nenit 39 parag. 3 nënparag. 3.1 të LPKVK-it.

-Në bazë të nenit 115 parag.2 lidhur me nenin 122, të KPPRK-së,kompjuteri HP me nr.serik... kompjuteri HP me numer serik :... kompjuteri HP me nr.serik :..., kompjuteri HP me nr.serik :... kompjetiri DELL me nr.serik :... printer me nr.seri..., janë KONFISKUAR.

A r s y e t i m

PTh-re, nga Gjilani me datën 24.07.2019, ka ngritur aktakuzen PP.nr. 999/2019, kundër të pandehurës P.H nga fshati ..., K. Viti, për shkak të veprës penale, organizim i skenave piramidale dhe bixhozit te pa ligjeshem nga neni 294 parag.2 të KPRK-së,

Asnjera nga palet nuk e ka kundërshtuar gjyqtarin e vetem gjykusë, dhe për të njeitin nuk paten asnji vërejtje.

Marëveshja mbi pranimin e fajsisë dhe sanksionit penal, i është paraqitur gjyqtarit të vetem gjykusë konform nenit 233 të KPPRK-së, dhe me dt.26.07.2019 është bërë pjesë perbarse e kësaj lënde penale.

Për vepren penale organizim i skenave piramidale dhe bixhozit te pa ligjeshem nga neni 294 parag.2 të KPRK-së, të pakten ligji parashef denim me gjobë ose me burgim prej 6 muaj deri në 5 vjetë.

Përfaqesusja e akuzës prokurorja e shtetit Rozelica Manastiri e ka njoftuar gjyqtarin e vetem gjykusë, për menyren e perpilimit, si dhe pelqimin e krye prokurorit, për lidhjen e marrveshjes, për pranimin e fajsisë, dhe sanksionin penal, si dhe heqjes dorë nga ndegjimi i dëshmitarit të propozuar si dhe shtjellimin e provave tjera material.

Mbrojtisi i të akuzuarës P.H. av. A.H. e ka njoftuar gjyqtarin e vetem gjykusë, për marrveshjen me perfaqesusin e akuzës, në presence të akuzuarit, duke hequrë dorë nga dëgjimi i dëshmitarve, dhe shtjellim i provave tjera.

Marëveshja mbi pranimin e fajsisë dhe të sanksionit penal, nga e akuzuara P.H, i përmbanë të gjitha faktet, duke bërë propozim për marrveshje mbi pranimin e fajsisë e cila është bërë në menyre vullnetare duke u deklaruar për arsyet e pranimit të fajsisë .

Gjykata ka gjetur te palet procedural marrveshjen mbi pranimin e fajsisë dhe të sanksionit penal, e kishin bërë conform dispozitave ligjore të nenit 233 të KPPRK-së. Gjykata gjeti dhe u bindë se e akuzuara , vepren penale e kishte kryer me dashje .

Pasi që palët procedural si PSH, e akuzuara dhe avokati i saj, kanë arritur këtë marrveshje mbi pranimin e fajsisë dhe të sanksionit penal, Gjykata atë aprovoi pa kurfar hezitim si të arritur me vullnet në mesë të palve procedural.

Me rastin e matjës së denimit ndaj të akuzuarës, gjyqtari i vetëm gjykusë morri për bazë marrveshjen e arritur me shkrim, dhe si rrethanë letsuse të cilat ndikuan në zbutjen e denimit, sjellja e sinqert e të akuzuarës P.H pendimi i thellë per kryrjen e kesaj vepre, ndersa si rrethana renduse morri pergjegjsien penale rrezikshmerin shoqrore me këtë vepër penale.

Gjykata është bindurë se denimi i shqiptuar me denim burg në kohëzgjatje prej 60(gjashte dhjet) diteve, I cili me pelqimin e te pandehures do te zavendsohet me denim me gjobë në shumë prej 1200 Euro, (Njëmijë e dyqin euro), ndaj të akuzuares është në harmoni me peshen e veprës penale, si dhe rrezikshmerin shoqrore, kështu që me këtë denim ka gjetur se do të arrihet qellimi i dënimit i parapar me KPRK-së.

Në bazë të nenit 83 paragrafi 1 të KPRK-së, duke ja llogaritur edhe kohën e kaluar nën masën e arrestit shtepiak prej dt.03.07.2019, deri me dt.31.07.2019, e akuzuara 30 ditë ka qëndruar nën masën e arrestit shtepiak, që do të thotë se e akuzuara ka për ta paguar shumën prej 600 €uro. (gjashqin euro), pasë plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi.

-Në bazë të nenit 115 parag.2 lidhur me nenin 122, të KPPRK-së, kompjuteri HP me nr.serik ... kompjuteri HP me numer serik :... kompjuteri HP me nr.serik :... kompjuteri HP me nr.serik :... kompjuteri HP me nr.serik :... kompjuteri HP me nr.serik :... printer me nr.seri..., janë KONFISKUAR.

Palet procedural- prokurorja e shtetit, e akuzuara dhe mbrojtësi i saj, kanë hequr dorë nga ankesa.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 451, të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELOR GJILAN DEGA NË VITI
P nr. 306/2019
Me.31.07.2019.

Sek. Juridike,
Azize Rama

Gjyqtari,
Nexhat Aliu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, palet procedural kanë hequr dorë nga ankesa dhe i njëjti nuk mundë të ankimohet.

Numri i lëndës: 2019:143707
Datë: 04.09.2019
Numri i dokumentit: 00493045